



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-033
Prishtinë, më 12 qershor 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 12 QERSHOR 2018

Në mbledhje morën pjesë: Nënkryetarët e Kuvendit: Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti, Slavko Simiq dhe Mufëra Serbica-Shinik.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Albulena Haxhiu, Driton Çausi, Ahmet Isufi, Enver Hoti dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi dhe Shefki Shoshaj.

Nga Ambasada Amerikane: Adem Gashi dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati,

Mbledhjen e kryesoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Nënkryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit,
2. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara,
3. Konfirmimi i rendit të ditës për seancën plenare më 14 qershor 2018 dhe
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme së Kryesisë së Kuvendit

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 31 maj 2018.

2. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, i njoftoi të pranishmit me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 5, 6 dhe 8 qershor 2018.

Kryesia, me propozim të nënkryetarit z. Haliti, vendosi që seanca plenare me pikat e papërfunduara më 5, 6 dhe 8 qershor 2018 t'i vazhdojë punimet të enjten, më 14 qershor 2018, para fillimit të seancës së re plenare, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurorit për vitin 2017,*
2. *Votimi i raportit vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017,*
3. *Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,*
4. *Votimi i propozim-Rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës,*
5. *Votimi i propozim-Rezolutës nga interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës,*
6. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në lidhje me*

vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikalo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve për grante dhe subvencione.

3. Konfirmimi i rendit të ditës për seancën plenare më 14 qershor 2018

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, i njoftoi të pranishmit se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 31 maj 2018 ka vendosur që seanca plenare të mbahet më 14 qershor 2018, në orën 10:00, por që rendi i ditës mund të plotësohet edhe pika të reja, të cilat procedohen ndërkohë.

Kryesia, pasi u njoftua me parashtrësats që i plotësonin kushtet për shqyrtim, vendosi që seanca plenare t'i zhvillojë punimet të martën, më 19 qershor 2018, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Interpelancë me ministren e Integritimit Evropian, znj. Dhurata Hoxha në lidhje me zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) për kuartalin e katërt (K4) 2017 dhe kuartalin e parë (K1) 2018,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet juridike,*
- 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale,*
- 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave,*
- 7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar,*
- 8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,*
- 9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017,*
- 10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017,*
- 11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017,*
- 12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017,*
- 13. Propozimi për formimin e Komisionit hetimor parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës,*
- 14. Propozimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018,*
- 15. Debat parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, 2019-2021.*

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Propozimi i GP të Lëvizjes Vetëvendosje për zëvendësimin e anëtarit në delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputeti Glauk Konjufca caktohet anëtar në delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, në vend të deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

2. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të delegacionit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s që do ta vizojnë Kosovën nga 28-30 qershor 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit, si dhe shpenzimeve tjera që dalin sipas programit zyrtar me rastin e pritjes së delegacionit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, për vizitën zyrtare që do ta realizojnë në Kosovë, nga 28 deri më 30 qershor 2018

3. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Slavko Simiq, për mbulimin e shpenzimeve për një drekë zyrtare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Slavko Simiq, për mbulimin e shpenzimeve për një drekë zyrtare, sipas faturës nr. 0028048, datë 29. 5. 2018, në shumën prej 101,00 €.

4. Njoftimi i deputetes Mimoza Kusari-Lila për realizimin e udhëtimit zyrtar në SHBA

Kryesia u njoftua me shkrim nga deputetja Mimoza Kusari-Lila për realizimin e vizitës zyrtare në SHBA, nga 23-27 prill 2018.

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:20 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit
Xhavit HALITI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale